

**VALAMAR 2 SH.P.K**  
**NJËSIA BASHKIAKE NR.2, RRUGA PAPA GJON PALI II, ABA BUSINESS CENTER, KATI 11-TË, ZYRA**  
**NR.1206, KODI POSTAR 1010, TIRANË**  
**NIPT: M22422028L**

---

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Sot, më 19.01.2023 (dy mijë e njëzet e tre) në orën 10.00, në selinë qendrore të VALAMAR 2 Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Kodi postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: M22422028L (këtej e tutje referuar si "Shoqëria") u mbajt Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Është e pranishme Shoqëria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor, znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe identifikuar me numër personal I35203147R; ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% të kapitalit themeltar të saj. Është e pranishme gjithashtu znj. Eva Veizaj në cilësinë e konsulentit ligjor të Ortakut te Vetëm.

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër drejtimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, fton Znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e Sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi shpreh vullnetin e Ortakut të vetëm për të vendosur mbi Rendin e Ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për mbledhje, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të mbledhur rregullisht, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", dhe mund të marrë vendime të vlefshme lidhur me Rendin e Ditës si më poshtë vijon:

**RENDI I DITËS**

- I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRINË VALAMAR 2 SH.P.K.;**
- II. TË NDRYSHME;**

\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja operationale të Shoqërisë kërkohet financimin i saj me një shumë prej 750,000 LEK (shtatëqind e pesëdhjetë mijë lekë), Financimi do të jepet në formën e kontributit në para në kapitalin e Shoqërisë i cili nga 100 LEK (njëqind lekë) do të zmadhohet në 750,100 LEK (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes në Rendin të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë VALAMAR 2 Sh.p.k., (NUIS M22422028L) me 750,000 LEK (shtatëqind e pesëdhjetë mijë lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nëshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetem në para. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 100 LEK (njëqind lekë) do të zmadhohet në 750,100 LEK (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind lekë).
- C. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "VALAMAR 2" Sh.p.k., mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KRYETARI



Z.NJ. EDLIRA MUKA  
ADMINISTRATOR

"BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP" SH.P.K.,



SEKRETAR



EVA VEIZAJ